

**PROTOKOLL BASHKËPUNIMI MIDIS QSPA-
së (QENDRËS SË STUDIMEVE DHE
PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT) DHE
FAA-së (FEDERATA E SHOQATAVE
ARBËRESHE)**

QSPA

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Duke pasur parasysh:

që QSPA është një Institucion publik, në varësi të Ministrit të Shtetit për Diasporën të Republikës së Shqipërisë, i themeluar me VKM Nr. 601, datë 04.09.2019, , me seli në Tiranë, rruga Ibrahim Rugova, Nr.5, pall. Sky Tower, kati 7, ap. 4, Tiranë;

që FAA, është një Federatë e Shoqatave Arbëreshe në territorin italian, e të drejtës private e pa qëllime përfitimi, me seli në Spezzano Albanese, piazza Repubblica, nr.9;

Duke marrë në konsideratë:

që trashëgimia historike e kulturore e Shqiptarëve të Italisë, të njohur me emrin Arbëreshë, njihet përgjithësisht si trashëgimi botërore;

që QSPA dhe FAA kanë si objektiv të përbashkët vlerësimin, evidentimin dhe përhapjen e gjuhës, historisë, letërsisë e të gjithë trashëgimisë kulturore, përpos asaj popullore e fetare të Arbëreshëve, si të formës materiale ashtu edhe asaj jomateriale e gojore;

që përdorimi i gjuhës shqipe si dhe i të folmeve të ndryshme të evoluara përgjatë shekujve në komunitetet e themeluara nga popullata të ardhura nga krahina shqiptare duke filluar nga shekullit XV e në vijim XVI e XVII, përbën kushtin e nevojshëm e të domosdoshëm për mbijetesën identitare të këtyre ngulimeve;

që ngritja e QSPA-së nga ana e Ministrisë së Diasporës shqiptare, përfaqëson një mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e nismave të studimeve dhe evidentimeve të shprehjeve kulturore arbëreshe;

që QSPA-ja mund të shndërrohet epiqendra dhe vendi ku të mblidhet dokumentimi (fizik i dokumenteve, fotografik, sonor, audioviziv e digjital) në lidhje me Arbëreshët i gjendshëm në Kalabri e në Itali;

DUKE KONSIDERUAR TË GJITHA SA MË SIPËR:

midis QSPA-së dhe FAA-së nënshkruhet ky Protokoll bashkëpunimi për trevjeçarin 1 shtator 2020 – 31 gusht 2023, me qëllim realizimin sa vijon më poshtë:

- Mbledhjen e teksteve dhe revistave, apo të çfarëdo materiali tjetër të shkruar, prodhuar nga e mbi Arbëreshët ndër shekuj; mbledhjen e të gjithë materialit sonor, fotografik, filmik e digjital të mundshëm që gjendet në struktura publike e private arbëreshe;
- Rigjetjen dhe rigjenerimin zanor e digjital të shprehjeve gjuhësore që përdoren aktualisht në komunitetet arbëreshe të Kalabrisë; përmbledhjen e leksikut aktual në tekstet e shkruara (libra e revista etj) nga 1945 deri më sot;
- Një kërkim krahasues midis Shqipërisë dhe Arbërisë mbi traditat popullore prezente në zonat arbëreshe e në disa zona të brendshme të qendrës e të jugut të Shqipërisë, me një vëmendje të veçantë ndaj territorit të krahinave të Elbasanit, Beratit, Përmetit e Korçës.

Për qëllimet e mësipërme ngrihet një Komitet operativ prej shtatë anëtarësh midis QSPA-së dhe FAA-së (3+3), plus vontën e Drejtorit Ekzekutiv të QSPA-së me detyrën për të përcaktuar projektet ekzekutive si dhe për të gjetur burimet për realizimin e tyre (në Kalabri e Shqipëri). Ky Komitet mblidhet të paktën dy herë në vit për t'i hapur rrugë aktiviteteve të programuara.

Drejtores ekzekutive të QSPA-së, po aq edhe Presidentit të FAA-së, iu rezervohet e drejta të depozitojnë me shkrim emrin e një zëvendësuesi të tyre, në ato raste kur e kanë të pamundur të jenë të pranishëm në mbledhjet e thirrura që më parë.

Përpos kësaj, vendoset që:

✓ FAA është Shoqata e referimit për QSPA-në në Kalabri e në të gjithë territorin gadishullor në ndërtimin e lidhjeve me Komunat, Shoqatat, Institutet private e Fondacionet, Institutet shkollore dhe me Fondacionin “Istituto Regionale della Minoranza Arbereshe di Calabria” (Institutet rajonale të Minorancës Arbëreshe të Kalabrisë);

✓ Nga ana e saj, QSPA, furnizon material të dobishëm për evidentimin e vlerave dhe promovimin e komuniteteve arbëreshe. Impenjohet të individualizojë studiues e personalitete teknike për organizimin e seminareve të studimit, kuvendeve, kërkimeve në terren, mbledhjes dokumentare që do të realizohet në territoret italo-shqiptare.

Komitetit të përbashkët me prani të barabartë anëtarësh, i kërkohet të individualizojë sektorë të tjerë ku mund të ndërhyhet për t’ia propozuar QSPA-së dhe FAA-së me qëllim fuqizimin e bashkëpunimit kulturor.

Ky protokoll nënkuptohet i rinovuar automatikisht në mangësi të dorëheqjes së njërës nga palët para ditës së gjashtëdhjetë të skadencës.

Për QSPA

Diana KASTRATI

Drejtor Ekzekutiv

Për FAA

Damiano GUAGLIARDI

President i Federatës